



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTER**

Lënda: Informacion për pjesëmarrjen e institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastrë në projektet ndërkufitare me financim të huaj.

Në kuadër të projekteve ndërkufitare IPA 2014-2020 (INTERREG, ADRION, PANORAMED, MED, BALLKANMED) të cilat janë projekte me rimbursim shpenzimesh dhe vlerësim performance, institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastrë ka aplikuar si partner në disa projekte për të cilat ka nisur zbatimin e tyre. Më poshtë do të gjeni një përmbledhje analitike për objektivat e secilit projekt në të cilat ne jemi në rolin e partnerit.

### **Projekti THEMA**

Projekti THEMA ofron një zgjidhje për rritjen dhe zhvillimin e zonave ndërkufitare duke përdorur teknologjitë e reja. Thema krijon inovacione në tri nivele:

- 1- Teknologjik, duke përfshirë një formë të re të sensorëve të vendndodhjes me bazë bluetooth dhe një mekanizëm inovativ të shpërblimit në Shqipëri.
- 2- Përmbajtësor: duke shfrytëzuar dhe pasuruar rrugët ekzistuese, duke u ofruar qasje të hapur të përmbajtjes prej agjentëve turistikë dhe operatorëve turistikë.
- 3- Në nivel social, duke promovuar socializimin dhe fuqizimin e përdoruesve. Përdoruesit përfundimtarë të THEMA janë turistë që mund të përfitojnë nga zgjidhja në mënyra të shumta, ndërsa në përfitues përfshihen gjithashtu operatorët turistikë agjentët turistikë si dhe profesionistët e turizmit në përgjithësi. Së fundi autoritetet vendore (Bashkia dhe Institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastrë) do të përfitojnë nga rritja e turizmit në zonën e tyre.

Objektivi i përgjithshëm është i dyfishtë:

- të përmirësojë përvojën e përgjithshme të përdoruesve që vizitojnë si turistë rajonin Ndërkufitar.
- të rrisë trashëgiminë natyrore dhe kulturore të rajonit përmes teknologjisë bashkëkohore dhe turizmit tematik, përmes rritjes së interesit të audiencës dhe ofrimit të shërbimeve të avancuara dhe cilësore për të gjithë.

Inovacionet që THEMA krijon, adresojnë objektivin e posaçëm dhe rezultojnë në përfundimin e përvojës së turistëve në zonën ndërkufitare dhe promovimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore përmes teknologjisë së re. Kjo çon në ofrimin e shërbimeve cilësore që mund të tërheqin audiencë të re (të rinjtë, dashamirësit e turizmit tematik) dhe zgjerojnë vizitën e tyre në këtë zonë, pasi përmes rrugëve tematike dhe aplikacionit celular paraqitet një sërë opsionesh dhe përmbajtjesh për përdoruesit ndërsa përmes mekanizmit të shpërblimit, turistët kanë motive

shtesë. Do të zhvillohet një event nisje dhe një përmblyllës për të informuar përfituesit rreth paketave tematike THEMA dhe zgjidhjes teknologjike. Gjithashtu do të organizohen evenimente të tjera promovuese për turistët dhe profesionistët e sektorit të turizmit, siç janë dy fam trips dhe dy ekspedita për demonstrim të shtypit. Një seri videosh prej tre spotesh promocionale me kohëzgjatje të vogël dhe një paketë shtypi që do të shpërndahet në dy ekspozita/panaie ndërkombëtare, si dhe një turne shtypi dhe material të tjera publicitare.

Hapat për realizimin e projektit THEMA:

- Hartimi dhe hedhja në hartë e rrugëve që do të jenë pjesë e tre paketave tematike. Sensorët e zgjuar të vendndodhjes, me bazë Bluetooth, do të instalohen në të gjithë rrugët për navigim dhe shpërndarje në telefonin celular të përdoruesit.
- Zhvillimi i aplikacionit për celular në Android dhe IOS, duke përfshirë rrugët, si dhe bashkëpunimin, shpërblimin dhe funksionalitetet e rekomandimit që mund t'u propozojnë përdoruesve rrugë të ngjashme me interesat, profilin ose kërkimet e mëparshme.
- Zhvillimi i funksioneve shtesë të integruara në aplikacionin celular për socializim dhe bashkëpunim midis përdoruesve. Këto funksionalitete përfshijnë:
  - inicimin dhe mirëmbajtjen e (hashtag) #THEMA në twitter dhe Instagram, ku përdoruesit mund të ngarkojnë fotografi nga rrugët e tyre dhe të komentojnë mbi fotot dhe postimet e përdoruesve të tjerë;
  - të ftojnë ose sfidojnë një përdorues tjetër në eksplorimin kooperativ
  - diskutimi me vendasit për një familjarizim më të thellë me zonën në një perspektivë natyrore kulturore dhe etnografike.
- Përcaktimi i paketave tematike turistike. Profesionistët mund të shfrytëzojnë paketat tematike dhe rrugët e ofruara nga projekti THEMA si dhe komuniteti dinamik dhe përdorues i projektit THEMA me qëllim të promovimit të biznesit të tyre duke rritur konkurrueshmërinë e tyre në tregun e kërkuar të sektorit të turizmit.

## **Projekti CULTURAL LANDS**

Cultural Lands është projekti që mundëson promovimin dhe ruajtjen e aseteve kulturore të zonës ndërkufitare (ZN) jo homogjene që lidhen nga një rrugë për të lulëzuar fushën e zhvillimit të turizmit.

Për më tepër, projekti mishëron krijimin e një rrjeti bashkëpunimi në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm vendor dhe rajonal në fushën e ruajtjes dhe promovimit të pasurive të ngjashme kulturore, si parakusht për zhvillimin e turizmit kulturor.

Bashkëpunimi i zonave ndërkufitare (ZN-re) demonstron përmes zhvillimit të një monopati tematik turistik e kulturor të ZN, në termat e zhvillimit të një shtegu të çertifikuar ndërkufitar të turizmit.

Nyjet e kësaj rruge do të jenë kryesisht ndërtesat historike me karakteristika të veçanta arkitekturore dhe kulturore, të lidhura fort me figurat historike, me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë së zonës ndërkufitare si destinacion turistik. Kështu do të krijohet një rrjet bashkëpunimi që mund të zgjasë dhe shumëfishojë efektin e saj në zonën ndërkufitare / Shqipëri-Greqi.

Rezultatet kryesore të pritura të projektit “CULTURAL LANDS” janë si në vijim:

Projektet infrastrukturore në lidhje me rehabilitimin e ndërtesave me karakteristika të veçanta

arkitektonike dhe kulturore:

- Bashkia Zitsa (Janinë Greqi lid partner): Ndërtesa e shkollës historike "Kaplanios" në bashkësinë lokale të Grammeno,
- Bashkia Metsovo ( Greqi partner): Ndërtesa historike "Tsanaka" dhe ndërtesa ish kinemase,
- Prefekti i qarkut Gjirokastrë / Shtëpia Muze "Avni Rustemi", bashkia Libohovë.
- Plani i Marketingut për Monopatin Kulturore Turistike të Zonës Ndërkufitare (Branding),
- Platformë ndërkufitare GIS për shërbime Kulturore dhe Turistike (Trilinguale),
- Aplikime Multimedia /Biblioteka elektronike të Aktiviteteve Kulturore të zonës ndërkufitare
- Baza Tematike e metodologjitë, teknologjitë, mjetet që lidhen me praktikat më të mira të mbrojtjes kulturore,
- Organizimi i dy seminareve të përbashkëta tematike (për të ditur ngritjen e kapaciteteve në fushën e ruajtjes inteligjente kulturore),
- Studimet e Qëndrueshmërisë.

## Projekti POLYPHONIA

Programi operacional identifikon Trashëgiminë Kulturore si bazën e një bashkëpunimi ndërkufitar. Ruajtja e trashëgimisë kulturore të përbashkët është e rëndësishme për të nxitur identitetin e përbashkët kulturor të zonës ndërkufitare, ndërkohë që përdorimi i saj i përbashkët mund të kontribuojë në rritjen e zhvillimit ekonomik. Një tipar bazë i përbashkët kulturor i zonës ndërkufitare është kënga polifonike. Meloditë e këngës polifonike janë ndër të paktat që kanë ruajtur *shkallën pentatonike animitonike* (një shkallë e përbërë nga pesë tone pa semitone), në repertorin botëror të polifonisë popullore.

POLIFONIA fokusohet në ruajtjen dhe përmirësimin e këtij elementi të përbashkët kulturor të zonës ndërkufitare, si një tipar dallues i kulturës dhe burimeve potenciale të zhvillimit të turizmit.

### Objektivat:

- Ruajtja dhe zhvillimi i një tradite muzikore që tenton drejt zhdukjes, si një element integral i Zonës së Ndërhyrjes.
- Promovimi dhe vlerësimi i këngës polifonike nëpërmjet zhvillimit të karakteristikave historike, muzikore dhe kulturore, në fushën e turizmit tematik.
- Regjistrimi dhe klasifikimi i të gjitha këngëve polifonike dhe traditave që lidhen me to në Zonën e Ndërhyrjes.
- Forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar në fushat e artit, kulturës dhe turizmit duke theksuar si muzikën polifonike ashtu edhe turizmin.
- Rritja e numrit të vizitorëve në Zonën e Ndërhyrjes.
- Përmirësimi i atraktivitetit të Zonave të Ndërhyrjes, zhvillimi i mekanizmave të TIK-ut dhe brandimi i përbashkët POLIFONIA, për mbështetje të strukturuar të zhvillimit të turizmit.
- Trajnimi, ndarja e njohurive dhe shkëmbimi i përvojave të profesionistëve dhe autoriteteve / organizmave (në lidhje me traditën muzikore, ruajtjen e saj dhe turizmin) në nivel lokal dhe ndërkufitar.

### Aktivitetet kryesore:

- Krijimi i dy qendrave në lidhje me promovimin e trashëgimisë muzikore polifonike dhe

- zhvillimit të turizmit tematik në zonën e ndërhyrjes.
- Krijimi i një rrjeti ndërkufitar të bashkëpunimit për të nxjerrë në pah traditën polifonike kulturore dhe për të promovuar mënyrat alternative të turizmit.
  - Krijimi i Muzeut të Realitetit Virtual Tematik.
  - Krijimi i një Brandi të Përbashkët POLIFONIA.
  - Hartimi dhe zhvillimi i rrugëve kulturore tematike dhe vendosja e shenjave informuese.
  - Krijimi i Arkivit Ndërkufitar të Muzikës Polifonike dhe bazës elektronike të të dhënave të këngëve polifonike.
  - Zhvillimi i Aplikacionit të Udhëzimeve Turistike për InfoKiosk Interaktive dhe Tablet / Smart Phone.
  - Elaborimi i studimit lidhur me zhvillimin e turizmit tematik në Zonën e Ndërhyrjes.
  - Hartimi i një Plani Marketingu për zhvillimin e këngës polifonike;
  - Organizimi i një Konference Ndërkombëtare për të përcaktuar këndimin polifonik si levë e zhvillimit të turizmit.
  - Organizimi i seminareve dhe vendeve të mësimit elektronik për turizmin tematik dhe këngën Polifonike.
  - Themelimi dhe Organizimi i Festivalit Ndërkombëtar të Muzikës Polifonike.